REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 3255/1 Prot.

Lushnje, më 12/04/2024

PROJEKT - VENDIM

NR. 42 DATË 12/04/2024

"MBI MIRATIMIN E SHPRONESIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I INVESTIMIT" PËR: "NDËRTIMI I OBJEKTIT 6KT+1KAT PARKIM NËNTOKË NË TRUALLIN NË PRONËSI TË ENTIT TË BANESAVE"

Këshilli i Bashkisë Lushnje, në mbledhjen e datës ___/ ___/2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni i Shpronësimeve në Bashkinë Lushnje, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 gërma "a", "b", "c" dhe nenit 54 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore" , ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë privatë për interes publik, të ndryshuar ; VKM Nr.127, datë 23.03.2000 " Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik; VKM nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" VKM nr.89 datë 03.02.2016" Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të RSH " .

PROPOZOJMË :

I.Të miratojë procedurën për shpronësim për interes publik për **"Ndërtim i Objektit 6kt+1kat parkim nëntokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave".**

II. Vlera totale e shpronësimit të llogaritur është në shumën **1,853,478** (një million e tetë qind e pesëdhjetë e tre mijë e katër qind e shtatëdhjetë e tetë) **lekë** e cila do përballohet nga Buxheti i Bashkisë Lushnje.

III. Ngarkohet Komisioni i Shpronësimeve për zbatimin dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme në institucionet kompetente.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORI JURIDIK

Bedri Hida

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Kryetar

Elton Korreshi

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 222139 Email:bashkia_lushnje@yahoo.com